

agjërimin." (Transmeton Ahmed)

Gjithashtu nga Abdullah ibën Amri transmetohet se i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kush dëshiron të largohet nga zjarri i xhehenemit dhe të hyjë në xhenet, le ta arrijë vdekjen duke besuar Allahun dhe Ditën e Fundit dhe le të sillet me njerëzit ashtu siç ka dëshirë Allahu."

(Transmeton Ahmed)

Nga Semure ibën Xhundub transmetohet se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Fjalët më të dashura tek Allahu janë katër: La ilahe il Allah, Allahu ekber, Subhanallah, Elhamdulillah. Nuk prish punë se me cilën ia fillon." (Transmeton Ahmed)

Transmetohet nga Mahmud ibën Lebid se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

"Kur Allahu e do një popull, Ai i sprovon ata. Kush bën durim, ai do të shpërblehet për durimin e tij e kush nuk bën durim edhe ai do të shpërblehet për të." (Transmeton Ahmed)

Shënim: Disa nga hadithet janë sahih dhe disa janë hasen.

Përgatiti: Alaudin Abazi

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare
Klubi Studentor

e-mail: penastudentore@hotmail.com



dhe nxitje për veprat e mira etj.

Parapërgatitje morale me të gjitha sjelljet e mira dhe largimi nga të gjitha sjelljet e këqia

Ka mundësi të bëhet kjo nëpërmjet leximit të librave që flasin për moralin ose t'i pyesësh pasuesit e sjelljeve të mira që të të japin këshilla rreth asaj që është jo e mirë për moralin, nëse gjinden.

Parapërgatitje për shfrytëzimin e kohës në Ramazan, duke bërë orar për leximin e Kuranit, vizitat për hir të Allahut, si dhe vizitat e të afërmëve etj.

Nxitje e xhematit të xhamisë për organizimin e iftareve të përbashkëta të përditshme ose të paktën njëherë në këtë muaj. Nxitje e xhematit për shkëmbimin e vizitave për hir të Allahut gjatë këtij muaji, si dhe takimin pas faljes së namazit të Bajramit në xhami ose në çfarëdo vendi të përshtatshëm për këtë.

E lusim Allahun të na e bëj të mundshëm arritjen e Ramazanit dhe të na ndihmojë në pritjen e tij dhe përmirësimin e veprave në të!

Ebu Ahmed

Përktheu: Zumer Konushevc

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare
Klubi Studentor

e-mail: penastudentore@hotmail.com



Transmetohet nga Abdullah ibën Mesudi se e ka pyetur Pejgamberin (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) se cila vepër është më e dashura tek Allahu? Ai është përgjigjur: *“Namazi në kohën e tij.”* Pastaj e ka pyetur: *“Pas kësaj cila?”* Ai tha: *“Respektimi i prindërve.”* Pastaj cila? - e ka pyetur përsëri. Ai është përgjigjur: *“Xhuhadi në rrugën e Allahut.”*

Ibën Mesudi thotë se i ka treguar për këto e po të vazhdoja ta pyesja, prap do të më tregonte. (Transmeton Buhariu)

Nga Enes ibën Maliku transmetohet se Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Ai njeri që dëshiron t'i shtohet furnizimi (rrizku) dhe t'i zgjatet jeta, le t'i mbajë marrëdhëniet farefisnore.” (Transmeton Buhariu)

Thotë Aishja se i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) është pyetur se cilat vepra janë më të dashura tek Allahu, ai tha:

“Ajo vepër që është e vazhdueshme edhe nëse është e paktë.”

Gjithashtu ka thënë: *“Ngarkojeni veten me vepra vetëm aq sa keni mundësi t'i përballoni!”* (Transmeton Buhariu)

Nga Ebu Musa transmetohet se Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Ai njeri që dëshiron takimin e Allahut edhe Allahu dëshiron takimin e tij; ai që urren takimin e Allahut edhe Allahu urren takimin e tij.” (Transmeton Buhariu)

Transmetohet nga Ebu Hurejre se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Kur Allahu i Lartësuar e do një njeri e thërret Xhibrilin dhe i

thotë: Allahu e ka dashë filanin, duaje edhe ti! E Xhibrili e do atë. Pastaj ai lajmëron në qiell se Allahu e do filanin, prandaj edhe ju duajeni atë! Dhe banorët e qiellit e duan atë. Pastaj ai njeri bëhet i pranuar te banorët e tokës.” (Transmeton Buhariu)

Nga Ebu Hurejre transmetohet se Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Vendet më të dashura tek Allahu janë xhamitë, ndërsa më të urryerat janë tregjet.” (Transmeton Buhariu)

Aishja trasmeton se i Dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Vepra më e dashur tek Allahu është ajo që është e vazhdueshme edhe nëse është e paktë.”

Aishja kur e bënte një vepër, vazhdonte në praktikimin e saj.” (Transmeton Muslimi)

Bera ibën Azib thotë se Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Ai që i do ensarët Allahu e do atë, kurse ai që i urren ensarët edhe Allahu e urren atë.” (Ibën Maxhe)

Nga Ebu Jusri transmetohet se i Dërguari (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Kush dëshiron që Allahu ta vendosë nën hijen e Tij, le të përkujdeset ndaj atij që ka vështirësi dhe le t'i ndihmojë atij.”

Abdullah ibën Amër ibën Asi thotë se Pejgamberi i Allahut (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë:

“Agjërimi më i dashur tek Allahu është agjërimi i Daudit, gjithashtu edhe namazi i tij është më i dashuri. Daudi flinte gjysmën e natës dhe falej një të tretën, pastaj vazhdonte e flinte një të gjashtën e tij. Kurse për agjërimin, ai një ditë agjëronte e një ditë e prishte

Ramazan, mirë se na vjen, mysafir i nderuar që shpejt do të na ikësh!

Në Ramazan shpërblimet dyfishohen, lidhen me pranga shejtanët, hapen dyert e xhenetit, mbyllen dyert e zjarrit. Thjesht, ai është muaj i mirësisë dhe bereqetit. Është mirë për ne që të përgatitemi në pritjen e tij sa më mirë. Mysafiri përgatitet për rrugën e tij, nëpunësi përgatitet me detyra ushtruese të punës së tij. Edhe djajtë përgatiten për këtë muaj ose i bëjnë të dyshimtë njerëzit për këtë muaj (para se te aplikohet prangimi i tyre) me lloje të ndryshme zbatimëse, sikur janë filmat dhe lojrat e kota. Pra, ne jemi muslimanë dhe është detyrë e jona që të bëhemi gati me përgatitjen më të vlefshme. Dhe, nuk ka gëzim më të madh se ai i cili e shfrytëzon Ramazanin që nga dita dhe momenti i parë.

SI TË PËRGATITEMI PËR RAMAZAN?

Me lutje

T'i lutemi Allahun që ky muaj fisnik të na arrijë ne, ashtu siç vepruan gjeneratat e para. Ata vetëm e lusnin Allahun gjashtë muaj qe t'i arrijë Ramazani. Pastaj e lusnin përsëri Allahun gjashtë muaj, derisa pranohej lutja e tyre. T'i lutemi Allahut të na ndihmojë që ta presim mirë atë dhe t'i përmirësojmë veprimet tonë në të. Gjithashtu, t'i lutemi Allahut t'i pranojë veprat tona në këtë muaj të ndershëm.

Me hapjen e zemrave tona ndaj myslimanve

Mos të ketë mes teje dhe ndonjë muslimani urrejtje, ashtu siç thotë i dërguari i Allahut, (Paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë mbi të!):

“Allahu i vështron të gjitha krijesat e Tij në natën e gjysmës së muajit shaban dhe i fal të gjitha krijesat e Tij, me përjashtim të atij i cili i bën shok atij dhe atij që urren.”

Me agjërim

Kështu ka vepruar i dërguari (alejhi selam). Kjo shihet nga

hadithi i Usame bin Zejdit (Allahu qoftë i kënaqur me ata dy!). Ai thotë: *“Thash: O i dërguar i Allahut, nuk të kam parë të kesh agjëruar në ndonjë muaj më shumë se sa agjëron në muajin shaban? Ai tha:*

“Ai është një muaj të cilin njerëzit e lenë pas dore, ngase është në mes muajit Rexhep dhe Ramazanit. Ai është muaj në të cilin veprat ngjiten te Zoti i botërave dhe unë dëshiroj që veprat e mia të ngrihen e unë të jem agjërueshëm.” (“Sahihu terhib ue terhib” 1012).

Duke u dhënë rëndësi detyrimeve

Siç është namazi i përbashkët në sabah dhe kohët e tjera, në mënyrë që mos të shkoj kot as vlera më e vogël e Ramazanit. Sa të kesh mundësi të largohesh nga gjynahet, të cilat janë pengesë për sevape (shpërblime).

Të falësh vazhdimisht namazin e natës dhe bësh rregullisht lutjet, si dhe të caktosh një pjesë të Kuranit për lexim çdo ditë, në mënyrë që mos të bëhemi përtac në mes të muajit, duke i shtuar kësaj kohe të caktuar për leximin e Kuranit, pas namazit dhe para tij ose mes akshamit dhe jacisë, ose përveç këtyre edhe vakte të tjera gjatë gjithë muajit shaban dhe Ramazan. Me ndihmën e Allahut ta bësh këtë edhe jashtë këtyre muajve.

T'i lexosh dhe mësosh rregullat e agjërimin, nëpërmjet librave, kasetave të dijetarëve, si dhe nga studentët që i njohin këto rregulla.

Përgatitje për thirrje në Islam gjatë Ramazanit me te gjitha mjetet, ngase shpirtërat janë të gatshëm të pranojnë thirrjen në këtë muaj, gjë që nuk ndodh jashtë këtij muaji. Në këto mjete bën pjesë: fjala e bukur në xhami ose në ndonjë vend të veçantë për një person a më tepër. Të japësh dhuratat ndonjë fletëpalosje ose kasetë të dobishme apo të krijosh hallkë përkujtuese, leximin e Kuranit në xhamia dhe shtëpi, tubimi i fetvave (vendimeve) rreth agjërimin dhe shpërndarjes së tyre, si